



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	Institucion i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	1328/2020
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.	
Data/Datum/Date:	19/08/20
POSHËNË PRËZINA PRISTINA	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio

Rasti nr. 720/2019

kundër

Komunës së Kamenicës

në lidhje me

riorganizimin në arsimin parauniversitar në komunën e Kamenicës

Për: Z. Qëndron Kastrati, kryetar, Komuna e Kamenicës  
Z. Ramë Likaj, ministër, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare, Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Bashkëngjitur në shtojcën e këtij rapporti: Instrumentet relevante ligjore

Prishtinë, më 19. gusht 2020

## Qëllimi i reportit

1. Ky rapport është iniciuar ex-officio (sipas detyrës zyrtare) nga Avokati i Popullit, duke u bazuar në informatat nga mediat si dhe nga ankesat individuale të ankuesve: z. Abedin Maliqi, z. Faik Demolli, z. Muhamrem Doda dhe z. Fatmir Cakolli,<sup>1</sup> lidhur me riorganizimin e arsimit parauniversitar në komunën e Kamenicës.
2. Ky rapport ka për qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të Komunës së Kamenicës dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (më tutje: MASH<sup>2</sup>) lidhur me respektimin e procedurave të riorganizimit në arsimin parauniversitar nga Komuna e Kamenicës në rapport me të drejtat e fëmijës.
3. Qëllimi i këtij rapporti është promovimi i barazisë si dhe tërheqja e vëmendjes së institucioneve publike lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse përzbatimin e ligjit dhe të të drejtave të njeriut në praktikë, e në veçanti të të drejtave të fëmijës, të mbrojtura me Kushtetutë, me ligje dhe me instrumente ndërkombëtare.

## Kompetencat e Avokatit të Popullit

4. Sipas nenit 135, par. 3, të **Kushtetutës së Republikës së Kosovës**: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
5. Gjithashtu, **Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit** përcakton se Avokati i Popullit, mes tjershë, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “Të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (neni 16, par. 4);
  - “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë” (neni 18, nënpar. 2);
  - “të rekomoandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, nënpar. 5).

## Përshkrimi i çështjes

6. Më 30 gusht 2019, kryetari i komunës së Kamenicës ka nxjerrë Vendimin 02 Nr. 26937, sipas të cilët riorganizohet arsimi sipas nivelit 0 dhe 1 të ISCED-së (niveli parashkollar dhe arsimi fillor 1-5), sipas të cilët:
7. Në institucionin arsimor “Dëshmorët e Kombit” vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU “Nuhi Berisha” nga fshati Tugjec, nxënësit e ShFMU “7 Shtatori” nga fshati Krilevë, dhe nxënësit e ShFMU “Idriz Seferi” nga fshati Strezoc, ndërsa në institucionin arsimor “Fan

<sup>1</sup> IAP, Rasti A.nr.719/2019, Maliqi dhe të tjërët/komuna e Kamenicës.

<sup>2</sup> Po ashtu, MASHT dhe MASHTI e kanë kuptimin Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

S. Noli” vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU “Hasan Prishtina nga fshati Busavatë. Po ashtu sipas këtij vendimi, riorganizohet edhe arsimi i nivelit 2 të ISCED-së (niveli i mesëm i ulët i shkollimit 6-9), sipas të cilët parashihet që në institucionin arsimor “Dëshmorët e Kombit” ta vijojnë mësimin edhe nxënësit e ShFMU “Nuhi Berisha” nga fshati Tugjec, nxënësit e ShFMU “7 Shtatori” nga fshati Krilevë dhe nxënësit e ShFMU “Idriz Seferi” nga fshati Strezoc, ndërsa në institucionin arsimor “Fan S. Noli” edhe nxënësit e ShFMU “Hasan Prishtina” nga fshati Busavatë.

8. Ndërsa sipas paragrafit 7, Drejtoria Komunale e Arsimit obligohet që me qëllim të njësimit të institucioneve arsimore të fuzionuara, t'i iniciojë procedurat për themelimin e institucioneve arsimore sipas UA/MASHT 08/2015 për Themelimin e Institucioneve Arsime.<sup>3</sup> Duke u bazuar në këtë paragraf, Komuna e Kamenicës fillimisht i ka fuzionuar institucionet arsimore dhe pastaj e ka obliguar DKA-në t'i iniciojë procedurat për themelimin e institucioneve arsimore, pa pasur vendim nga ministri i MASHT-it.
9. Po ashtu lidhur me riorganizimin e institucioneve të arsimit në komunën e Kamenicës, ka pasur mospajtime dhe reagime të ashpra nga banorët e fshatrave, të cilat i kanë shprehur edhe me protesta.
10. Më 21.10.2019, inspektorët e arsimit, me qëllim të konstatimit të gjendjes aktuale në shkollat e komunës së Kamenicës, lidhur me fuzionimin e shkollave – moszhvillimin e procesit edukativo-arsimor, i kanë inspektuar institucionet arsimore të prekura me vendimin e kryetarit të komunës së Kamenicës si dhe e kanë përpiluar procesverbalin lidhur me kryerjen e inspektimit tematik, me numër reference: 10/6, Nr. Prot.:470/19, i datës 22.10.2019. Sipas këtij procesverbali, inspektorët e arsimit vlerësojnë se, duke pasur parasysh numrin prej 107 nxënësh si dhe ndërtimin e objektit të ri shkollor që është në përfundim e sipër, nxënësit e ShFMU “Hasan Prishtina” në fshatin Busavatë duhet ndjekur mësimin në të njëjtën shkollë.
11. Ndërsa për ShFMU “7 Shtatori” në fshatin Krilevë, me 25 nxënës, dhe ShFMU “Idriz Seferi” në fshatin Strezoc, me 75 nxënës, kanë vlerësuar se ato duhet të fuzionohen në një shkollë të përbashkët për shkak të distancës së vogël gjeografike.
12. Inspektorët e arsimit SIA në Gjilan, pas konstatimeve të gjetura në DKA-në e Kamenicë dhe kryerjes së inspektimeve në institucionet edukativo-arsimore, kanë rekomanduar:
  - DKA-ja në Kamenicë të gjejë forma dhe zgjidhje për stabilizimin e gjendjes në shkollat e lartpërmendura.
  - DKA-ja në Kamenicë t'i pajisë shkollat me ditarët e klasave dhe me tekstet shkollore.
13. Përkundër këtyre rekomandimeve, të cilat, deri në momentin e përpilimit të këtij raporti nuk janë zbatuar, Inspektorati i Arsimit nuk ka bërë riinspektimin dhe nuk është kujdesur për zbatimin e rekomandimeve dhënë DKA-së në Kamenicë.

---

<sup>3</sup> Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.08/2015 për Themelimin e Institucioneve Arsime, ky UA ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe procedurave për themelimin e institucioneve arsimore, sipas nenit 2, përcaktohet: “*Themelimin e shkollës dhe të paraleles së ndarë fizike e bën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejmë Ministria).*” Po ashtu, sipas nenit 6 përcaktohet: “*Pas verifikimit të kushteve për zhvillimin e punës edukative-arsimore në shkollë, Ministri merr vendim për themelim.*”

14. Më 25.2.2020, duke u bazuar në komunikatën e MAShTI-t,<sup>4</sup> thuhet: “*Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, së bashku me kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, në një konferencë të përbashkët për media, në mjediset e MAShTI-it, kanë bërë të ditur se Ministria dhe Komuna e Kamenicës kanë harmonizuar qëndrimet lidhur me procesin e riorganizimit të institucioneve arsimore të filluar kohë më parë nga Komuna e Kamenicës...*” (Memorandum Bashkëpunimi 01-B Nr.i Prot.648, të datës 26.02.2020).
15. Më 27 shkurt 2020, përfaqësuesi i IAP-së, përmes shkresës elektronike, ka kërkuar nga MAShTI kopjen e Memorandumit të Bashkëpunimit 01-B Nr. i Prot.648, i datës 26.2.2020.
16. Më 9 mars 2020, përmes postës elektronike, MAShTI ia ka përcjellë përfaqësuesit të IAP-së informatat lidhur me çështjen e riorganizimit të arsimimit në komunën e Kamenicës si dhe kopjen e Memorandumit të Bashkëpunimit, të lidhur ndërmjet MAShTI-t dhe Komunës së Kamenicës. Ndër tjerash, në shkresën e dërguar thuhet se Memorandumi i Bashkëpunimit: “... përcakton se procesi i reformës së filluar në shtator 2019 do të vazhdojë të implementohet, ndërkohë që zbatimi i vendimit të Kryetarit të Kamenicës, i nxjerrë në muajin janar 2020 do të shtyhet...”

#### **Analiza ligjore**

17. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21 shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t'i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohet nga të gjithë.
18. Të drejtën e arsimit, Kushtetuta e garanton si të drejtë të përgjithshme të njeriut që e gjëzon çdo person (neni 47, paragrafi 1), po ashtu Kushtetuta i garanton çdo personi mundësi të barabarta të shkollimit në bazë të nevojave dhe të aftësive individuale, që do të thotë se në realizimin e së drejtës së arsimit nuk lejohet të ketë kurrfarë diskriminimi (neni 47, paragrafi 2). Këtë dispozitë kushtetuese e përbajnjë më tutje ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, të cilat parashohin që në zbatimin e të drejtave dhe të obligimeve të veta, qeveria, ministritë dhe komunat duhet t'i respekojnë të drejtat e fëmijëve, duke u mundësuar arsimin dhe mësimin në pajtim me dispozitat ligjore dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
19. Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gjëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tillë si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia etnike, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
20. Konventa për të Drejtat e Fëmijës përcakton se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, të pushojë dhe të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimitari çlodhëse, në përshtatje me moshën,

<sup>4</sup> <https://masht.rks-gov.net/article/komunikate-40>

realizimin e të cilave edhe institucionet arsimore duhet ta mbështesin. Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton se mungesa e gjatë e fëmijës në familje, koha e shkurtër për pushim dhe argëtim paraqesin kufizime të të drejtave të tyre.

21. Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, duke u bazuar edhe në Rregulloren Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shtojca 6, MASHT-i ka nxjerrë udhëzimet administrative të cilat përcaktojnë kriteret për numrin maksimal të nxënësve në klasë, raportin mësimdhënës-nxënës, kriteret dhe procedurat e themelimit të shkollave. Gjithashtu në to përcaktohet se themelues i shkollave është MASHT-i dhe se DKA-ja e ka obligim ligjor që t'i bëjë kërkesë me elaborate themeluesit për themelimin e shkollës.
22. Fakti se nxënësve të shkollave në fshatin Krilevë dhe Strezoc nuk u janë shpërndarë tekstet shkollore po ashtu është në kundërshtim me dispozitat ligjore,<sup>5</sup> të gjithë nxënësit e shkollave të tjera janë pajisur me tekste shkollore, prandaj trajtimi ndryshe i nxënësve të këtyre shkollave është trajtim i pabarabartë dhe është diskriminues.
23. Duke u bazuar në këto që u thanë më lart, numri i vogël i nxënësve është i vetmi arsyetim i qëndrueshëm, ndërsa asnjë kufizim nuk mund të arsyetohet për shkak të mungesës së buxhetit, mungesës së infrastrukturës shkollore apo mungesës së laboratorëve.
24. Komuna e Kamenicës është vend kodrinor – malor, me disa lugina rreth lumenjve, karakteristikat kryesore të komunës janë: terren kodrinor-malor 60%, dhe të rrashëta (40%). Në qytet jetojnë rreth 7831 banorë; në fshatra jetojnë rreth 28219 banorë; rritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 0.29%.<sup>6</sup>
25. Të gjitha këto karakteristika janë të nevojshme të merren parasysh, ashtu që masat e ndërmarra të janë të bazuara në nevojat e komunitetit dhe të nxënësve. Masat e ndërmarra mund të kenë efekt pozitiv nëse janë të pranueshme edhe për komunitetin.

#### Vendimet e kryetarit të komunës së Kamenicës

26. Në rastin konkret, edhe pse nuk bëhet fjalë për themelimin e shkollave të reja, riorganizimi drejtpërdrejt ka ndikuar në mbylljen e disa shkollave (Vendimi 02 Nr. 26937, i datës 30.8.2019). Ndërsa Vendimi 02 Nr.805, i datës 10.1.2020, për riorganizimin e shkollave ka ndikuar në organizimin e shkollave sipas niveleve. Në të dy rastet, DKA-ja ka pasur obligim që paraprakisht t'i drejohej me kërkesë dhe elaborate MASHTI-t, dhe pas analizës, ministri do të duhej të nxirrte vendim dhe tek pastaj do të mundë të bëhej riorganizimi.
27. Vendimet e kryetarit të komunës së Kamenicës (02 Nr.26937, i datës 30.8.2019 dhe 02 Nr.805, i datës 10.1.2020) citojnë disa dispozita ligjore në të cilat pretendojnë të bazohen (shih hyrjen e vendimeve). Mirëpo, gati të gjitha dispozitat e cituara përcaktojnë vetëm përgjegjësi të përgjithshme të kryetarit, pa i dhënë ndonjë autorizim specifik lidhur me riorganizimin e arsimit parauniversitar.
28. Këto dispozita, për shembull, përcaktojnë se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në ofrimin e arsimit publik parashkollar, fillor dhe të mesëm,

<sup>5</sup> Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.13/2016 pajisja e nxënësve me tekste shkollore, përdorimi dhe ruajtja e tyre.

<sup>6</sup> <https://kk.rks-gov.net/kamenice/qyteti/historiku/>

duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit.<sup>7</sup>

29. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, Avokati i Popullit konstaton se dhënia e shërbimeve publike është detyrim i komunës, ato duhet të ofrohen duke i zbatuar standardet e përcaktuara nga MASHTI.
30. Po ashtu citohen dispozitat të cilat përcaktojnë përgjegjësitë e kryetarit të komunës, siç janë: udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj, ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplikite kuvendit të komunës dhe organizon punën dhe drejton politikën e komunës.<sup>8</sup>
31. Ndërsa në paragrafin 9 citohen dispozitat e Ligjit 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nen 4, parografi 4.1, i cili përcakton se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe të administratorëve, pra edhe sipas kësaj dispozite nuk ka asnje autorizim specifik për riorganizimin e arsimit parauniversitar.
32. Këto citime tregojnë se komuna e ka për detyrë t'i zbatojë ligjet në fushën e arsimit, të njëjtat nuk i referohen ndonjë ligji që jep një autorizim eksplisit për ndërhyrjen e kryetarit të komunës në çështjen e riorganizimit, sipas të cilit mbyllen, fuzionohen dhe ndahen shkollat sipas niveleve, pa i zbatuar dispozitat ligjore dhe pa bashkëpunuar me MASHTI-n si ministri përgjegjëse.
33. Vendimi 02 Nr.26937, i datës 30.8.2019, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon që të mbyllen shkollat në fshatin Tugjec, Krilevë, Strezoc dhe Busavatë, prandaj, edhe pse kryetari i komunës ka të drejtë ta riorganizojë sistemin arsimor në kuadër të institucioneve arsimore të themeluara nga MASHTI, kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me MASHTI-n, prandaj veprimi i tillë përbën ndërhyrje në kompetencat e MASHTI-t dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lart.
34. Me zbatimin e këtij vendimi, nxënësit e fshatrave Busavatë, Krilevë, Strezoc, Tugjec dhe Zajqec do të transportohen në shkollat e qytetit të Kamenicës, me këtë veprim shkollat e themeluara nga MASHTI në këto fshatra do të mbyllen. Vendimet e nxjerra nga MASHTI për themelimin e shkollave, derisa të jenë në fuqi, duhet të respektohen nga Komuna, ato nuk mund të anulohen e as të shfuqizohen nga Komuna.<sup>9</sup>
35. Vetë vendimet e kryetarit të komunës vërtetojnë se Komuna obligohet që riorganizimin ta bëjë në bazë të dispozitave ligjore dhe në bashkëpunim me MASHTI-n (parografi 7), i cili obligon DKA-në t'i iniciojë procedurat për themelimin e institucioneve arsimore sipas UA/MASHT 08/2015 për Themelimin e Institucioneve Arsimore.
36. Avokati i Popullit vëren se pikërisht sipas këtij udhëzimi përcaktohet: Themelimi i një shkolle është kompetencë ekskluzive e MASHTI-t (neni 2), Drejtoria Komunale e Arsimit i bën kërkesë me elaborate themeluesit për themelimin e shkollës (neni 3) dhe ministri duhet të marrë vendim për themelim të shkollës (neni 6). Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, organet komunale fillimisht kanë pasur obligim ligor që të parashtojnë kërkesë

<sup>7</sup> Ligji nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nen 17, parografi 1, nënparagrafi h.

<sup>8</sup> Po aty, nen 58, parografi 1, nënparagrafi b, c dhe g.

<sup>9</sup> Neni 53, parografi 1, Ligji nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

me elaborate në MAShTI dhe vetëm pas vendimit të ministrit të MAShTI-t mund të bëhet riorganizimi.

37. Po ashtu, më 10.1.2020, kryetari i komunës ka nxjerrë Vendimin 02 Nr.805, sipas të cilit riorganizohet arsimi në dy shkolla të fshatrave Koretin dhe Topanicë, sipas të cilit parashihet që niveli parashkollor dhe arsimi fillor 1-5 ta vijojnë mësimin në shkollën e fshatit Koretin, ndërsa niveli i mesëm i ulët i shkollimit 6-9 ta vijojë mësimin në shkollën e fshatit Topanicë. Meqë vendimi në fjalë nuk ndikon drejtpërdrejt në mbylljen e shkollave, por vetëm i riorganizon ato sipas niveleve, Avokati i Popullit vlerëson se Komuna ka të drejtë ta riorganizoje sistemin arsimor, shkollat mund të kombinohen dhe mund të funksionojnë edhe të ndara sipas niveleve, por kjo duhet të bëhet gjithnjë duke i zbatuar dispozitat ligjore. Edhe emërimi dhe riemërimi i shkollave është kompetencë e MAShTI-t.
38. Kryetari i komunës së Kamenicës, z. Qëndron Kastrati, ka thënë për gazeten “Epoka e re”,<sup>10</sup> se nuk do të ketë mbyllje të shkollave, por riorganizim të tyre. Ai ka theksuar se kjo reformë ka për synim që të mos ketë më pak se 20 nxënës në klasë dhe më pak se dy paralele në gjeneratë.<sup>11</sup>
39. Duke pasur i parasysh dispozitat ligjore, në një klasë/paralele duhet të jenë 30 nxënës në nivelin e parë dhe 32 nxënës në nivelin e dytë, ndërsa raporti mësimdhënës-nxënës për komunitetin shumicë në nivelin e parë (1-5) dhe në nivelin e dytë (6-9) është një mësimdhënës për 21.3 nxënës, gjithashtu, për nxënësit e shkollave të zonave malore lejohet që raporti mësimdhënës-nxënës të jetë një mësimdhënës për 14.3 nxënës,<sup>12</sup> ndërsa, në paralelet e ndara lejohet që një klasë të ketë pesë nxënës,<sup>13</sup> prandaj qëndrimi i kryetarit të komunës është në kundërshtim me këto standarde të përcaktuara nga MAShTI.
40. Në të gjitha veprimet e ndërmarra, posaçërisht në çështjet administrative, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të merren parasysh në pajtim me moshën dhe pjekurinë e fëmijës si dhe në interesin më të mirë të tij. Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund ta justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njojur nga Konventa.
41. Familja, duke qenë njësi themelore e shoqërisë, në rend të parë e mban përgjegjësinë për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës.
42. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë ta përfaqësojnë fëmijën e tyre, kjo nënkuption obligimin e tyre edhe për t'u kujdesur që të drejtat e tij të respektohen me qëllim të sigurimit të mirëqenies, edukimit dhe arsimimit të tij.
43. Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimitari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën, zhvillimin fizik dhe mendor.

<sup>10</sup> <https://www.epokaere.com/riorganizim-i-shkollave-eshte-ne-te-mire-te-nxenesve-askush-nuk-mbetet-papune/> 27 gusht 2019

<sup>11</sup> Të njëtin qëndrim, kryetari i komunës e ka pohuar edhe gjatë takimit me përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit, takimi i datës 7.11.2019.

<sup>12</sup> Udhëzimi Administrativ Nr.22/2013 numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës, neni 3, paragrafët 3, 4 dhe 6.

<sup>13</sup> Neni 5, paragrafi 2, i Udhëzimit Administrativ nr.29/2012 për Themelimin e Paraleleve të Ndara.

44. Përfaqësuesi i IAP-së e ka vizituar fshatin Busavatë, ka biseduar me drejtorin e shkollës, i cili lidhur me çështjen i ka shprehur shqetësimet e veta. Sipas riorganizimit, nxënësit e këtij fshati duhet të udhëtojnë 6.90 km në një drejtim, kësaj distance duhet shtuar edhe distancën e lagjeve të tjera, fëmijët e të cilave vijojnë mësimin në këtë shkollë, e që sipas pohimit të drejtorit të shkollës janë distanca mjaft të largëta (lagja e Oranëve 5.20 km, lagja e Bajrovitëve 4.10 km etj.).
45. Po ashtu janë vizituar edhe fshatrat Krilevë dhe Strezoc dhe, sipas informatave të siguruara nga mësimdhënësit dhe nga prindërit e nxënësve, nxënësit duhet të udhëtojnë nga 19.20 km në një drejtim.
46. Sipas prindërve të fshatit Tugjec, nxënësit duhet të udhëtojnë mbi 17.10 km, grumbullimi i nxënësve bëhet në oborret e shkollave, nëse kësaj i shtohet edhe distanca të cilën shumica e nxënësve e kalojnë në këmbë deri në vendgrumbullim, atëherë një nxënës për të vijuar mësimin duhet t'i fillojë përgatitjet nga ora 6:00 e mëngjesit, autobusi i merr nxënësit në orën 7:15 minuta, ndërsa kthehen nga shkolla rreth orës 13:30 minuta.
47. Udhëtimi i rregullt dhe i gjatë i nxënësve nga vendbanimi deri në shkollë dhe anasjelltasështë i lodhshëm dhe mund të konsiderohet edhe i rrezikshëm për moshën e fëmijëve, terreni kodrinor-malorështë i vështirë për udhëtim, sidomos gjatë sezonit të dimrit, prandaj fëmijët të cilët udhëtojnë kanë më pak kohë të lirë, më pak kohë për lojë dhe më pak kohë për pushim. Kufizimet e këtyre të drejtave në krahasim me fëmijët e qytetit paraqesin trajtim të pabarabartë, pra një nxënës i cili jeton në fshat duhet të udhëtojë disa kilometra deri në shkollë dhe anasjelltas, ndërsa një nxënës i cili jeton në qytet i gjëzon këto të drejta pa asnjë kufizim.

#### **Raporti për riorganizimin e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në komunën e Kamenicës**

48. Në Raportin për riorganizimin e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në komunën e Kamenicës<sup>14</sup> pëershruhen vështirësítë e ndryshme me të cilat përballet arsimi në Kosovë, pëershruhet edhe gjendja e arsimit në komunën e Kamenicës (faqe 3). Sipas tij, komuna e Kamenicës po përballet me rënie drastike të numrit të nxënësve, kryesisht për arsyet e emigrimit dhe rënies së natalitetit.
49. Avokati i Popullit vëren se në rritjen e emigrimit dhe zvogëlimin e lindjeve ndikojnë shumë faktorë, si: kushtet natyrore, zhvillimi ekonomik, faktorët socialë, niveli i shërbimeve etj. Në komunën e Kamenicës, në viset rurale kushtet natyrore janë të vështira, ka ngecje në zhvillimin ekonomik dhe kushtet sociale janë të vështira për shkak të papunësisë, shërbimet komunale janë të dobëta, mungojnë shërbimet shëndetësore, aq më tepër, në fshatin Svircë ka pasur familje e cila nuk është furnizuar me energji elektrike deri në vitin 2019<sup>15</sup>. Po ashtu mbyllja e shkollave do të ndikojë edhe më shumë në emigrimin e banorëve. Komuna e Kamenicës duhet të angazhohet që të ofrojë shërbime publike më të mira për t'i inkurajuar banorët e fshatrave që ta vazhdojnë jetën në këto zona të cilat janë edhe zona kufitare.

<sup>14</sup> Raport i muajit gusht 2019, i pranuar nga DKA-ja në Kamenicë.

<sup>15</sup> IAP, Ex Officio, Rasti nr.14/2018, OIK/KEDS

50. Po ashtu, sipas këtij raporti, konstatohet se numri në rënie i nxënësve nuk është përcjellë me ndryshime në stafin arsimor në komunën e Kamenicës, shkollat kanë staf pothuajse të njëjtë sikurse para 10 vjetësh.
51. Avokati i Popullit vëren se gjendja e tillë në institucionet arsimore nga viti 2011 e deri në vitin 2019 është krijuar pa fajin e nxënësve dhe të prindërve. Edhe gjatë qeverisjes aktuale, nuk janë bërë veprime që situata të ndryshonte.<sup>16</sup>
52. Sipas raportit thuhet: “*Nëse trendi i rënies në 10 vitet e fundit vazhdon me të njëjtin ritëm - pas 5 vitesh, shumë shkolla do të mbesin pa nxënës, ndërsa pas 10 vitesh, vetëm 3 shkolla do t’i kenë më shumë se 20 nxënës. Ky argument është vërtetë shqetësues, trendi i rënies së numrit të nxënësve është shqetësues edhe në nivel vendi.*”
53. Meqenëse zvogëlimi i numrit të nxënësve po ndodh në tërë Kosovën, Avokati i Popullit konsideron se MASHTI duhet të angazhohet që të vendosen standarde përkatëse ligjore, të cilat do të respektohen në tërë vendin njësoj dhe pa dallime, duhet të ketë trajtim të barabartë për të gjithë nxënësit. Lidhur me rastin konkret, në shumë shkolla të vendit, edhe përkundër numrit të vogël të nxënësve, procesi i mësimit vazhdon, pra nuk mund të arsyetohet trajtimi i ndryshëm i nxënësve, sipas vendbanimit ku jetojnë.
54. Nxënësit e komunitetit rom, të cilët kanë vijuar mësimin në ShFMU “Idriz Seferi” në fshatin Strezoc,<sup>17</sup> që e kanë zgjedhur gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare për mësim, pavarësisht se u është ofruar transporti, tanë vijojnë mësimin në gjuhën serbe në ShF “Bratsvo”(shkollë e cila me nxënësit e komunitetit rom i ka 35 nxënës) në të njëjtin fshat. Sipas pohimit të prindërve, disa nxënës kanë vështirësi në mësimnxënje, pasi që nuk e njohin mjafthueshëm gjuhën serbe.<sup>18</sup>
55. Avokati i Popullit konstaton se, sipas Kushtetutës, komunitetet kanë të drejtë të marrin arsimin publik në njëren nga gjuhët zyrtare, sipas zgjedhjes së tyre, në rastin konkret, Komuna ua ka ofruar vazhdimin e procesit mësimor në gjuhën shqipe, por për shkak të udhëtimit të gjatë, nxënësit nuk kanë pranuar ta vijojnë mësimin në Kamenicë dhe pa dëshirën e tyre vazhdojnë mësimin në gjuhën serbe. Prindërit e komunitetit rom kërkojnë që fëmijët e tyre të vijojnë mësimin në gjuhën shqipe në shkollën e mëparshme.
56. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se institucionet publike duhet të miratojnë masa adekuate për ta promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve dhe se këto masa nuk do të konsiderohen diskriminuese,<sup>19</sup> në rastin konkret, komuniteti rom dhe komuniteti serb nuk janë trajtuar njëjtë, për shkak se shkolla në gjuhën serbe, edhe përkundër numrit të vogël të nxënësve, vazhdon të funksionojë, ndërsa lidhur me vijimin e mësimit të nxënësve të komunitetit rom është vendosur që ata ta vijojnë mësimin në Kamenicë.

<sup>16</sup> Në vitin 2018 dhe në vitin 2019, DKA-ja në Kamenicë ka shpallur 21 konkurse dhe janë kërkuar për punësim 62 vende të punës. Ueb-faqja e Komunës së Kamenicës.

<sup>17</sup> Më datën 3.11.2019, përfaqësuesi i IAP-së ka pranuar përgjigjen nga DKA-ja: “*Ne kemi formuar një grup që do të merret me inkudrimin e nxënësve rom në Kamenicë, në shkollën që është caktuar për ta bashkë me nxënësit tjera, pasiqë të rjejtit shkollimin janë duke e vijuar në një shkollë serbe afér vendbanimit të tyre.*” Nxënësit e komunitetit rom ende nuk janë integruar dhe vazhdojnë mësimin në gjuhën serbe.

<sup>18</sup> Informatat e pranuara nga prindi Gani Berisha, banor i komunitetit rom në fshatin Strezoc, kërkesa me shkrim nga prindërit e komunitetit rom si dhe nga një mësimdhënës i ShF “Bratsvo” i komunitetit serb.

<sup>19</sup> Neni 58, par. 4, i Kushtetutës.

57. Sipas rezultateve të Testit të Arritshmërisë, në 5 vjetët e fundit ka një rënie në arritshmërinë e nxënësve në komunën e Kamenicës. Në vitin shkollor 2014/2015 deri në vitin shkollor 2018/2019, rezultatet kanë rënë nga 69.00 % në 63.00% (tabela faqe 9). Sipas kësaj vërehet se ka rënie të rezultateve në të gjitha shkollat e komunës.
58. Qëllimi kryesor i propozimit për Riorganizimin e Shkollave është ngritja e cilësisë në arsim për nxënësit e komunës së Kamenicës (faqe 9). Avokati i Popullit vëren se MASHTI miraton të gjitha politikat arsimore dhe dokumentet e tjera që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e performances së institucionit arsimor.<sup>20</sup>
59. Avokati i Popullit pajtohet plotësisht se duhet të ndërmerren veprime për ngritjen e cilësisë në arsim, por veprimet e tillë duhet të ndërmerren në pajtim me dispozitat ligjore.
60. Një tjetër faktor që ndikon në mësim cilësor është edhe infrastruktura shkollore, e cila duhet të ofrojë kushte të përshtatshme për realizimin e mësimit bashkëkohor (faqe 11). Avokati i Popullit konstaton se objekti në fshatin Strezoc është objekt i cili i plotëson kushtet për zhvillimin e procesit mësimor, po ashtu në fshatin Busavatë ekziston shkolla e re e sapondërtuar, ndërsa nxënësit e këtyre shkollave, sipas vendimit për riorganizim, duhet ta vijojnë mësimin në ShFMU “Fan S. Noli” në Kamenicë.
61. Sipas këtij raporti, komuna e Kamenicës i ka 2968 nxënës (faqe 3), parashihet që më shumë se gjysma e tyre duhet të udhëtojnë deri në shkollë, duke filluar nga distanca më pak se 25 km (tabela faqe 17). Avokati i Popullit vëren se udhëtimi i nxënësve shkakton lodhje, gjë që mund të ketë ndikim negativ në mësiminxënie dhe në ngritje të cilësisë.
62. Po ashtu sipas raportit, Komuna e Kamenicës, me qëllim të ofrimit të kushteve sa më të mira për edukim dhe arsimim të fëmijëve, është e angazhuar në rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor në kushte të barabarta për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh vendbanimin e tyre (faqe 13). Nëse qëllimi është që këto objekte të përshtaten për institucione parashkollore, atëherë Avokati i Popullit vëren se, sipas nenit 5, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 29/2012 përcaktohet se numri minimal i nxënësve në një klasë në paralele të ndarë duhet të ketë jo më pak se pesë (5) nxënës, ndërsa grupet edukative sipas grup-moshave në institucionet parashkollore lejohen të formohen me nga 10 fëmijë për grup.<sup>21</sup> Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita, hapja e institucioneve parashkollore do të jetë edhe më e vështirë se hapja e një paraleleje të ndarë për shkak të numrit të vogël të fëmijëve në këto lokalitete.
63. Avokati i Popullit e përkrahë hapjen e institucioneve parashkollore dhe përfshirjen e fëmijëve në këto institucione, për këtë qëllim, në raportet vjetore<sup>22</sup> ka rekomanduar që nëpërmjet ngritjes së kapacitetit të infrastrukturës fizike, të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët. Komuna e Kamenicës, përvèç kësaj çështjeje, duhet ta shqyrtojë mundësinë që në fshatrat të cilat nuk i plotësojnë kushtet për shkolla amë, t'i rishikojë mundësitet për themelimin e paraleleve të ndara në fshatrat në të cilat plotësohen kriteret sipas neneve 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 29/2012 për Themelimin e Paraleleve të Ndara.

<sup>20</sup> Neni 9, par. 1, i Udhëzimit Administrativ Nr.4/2017 për vlerësimin e performances së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar.

<sup>21</sup> Shih nenin 5, Raporti edukator-fëmijë sipas grup-moshave, Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë.

<sup>22</sup> Raporti Vjetor 2011 dhe Raporti Vjetor 2012.

64. Riorganizimi i shkollave lë të lira 19 objekte shkollore, në fshatra të ndryshme. Komuna ka një plan për rivitalizimin e këtyre objekteve dhe për shfrytëzim të këtyre objekteve sipas nevojave të komunitetit ku ndodhen ato (faqe 18). Duke u bazuar në kërkesat e komuniteteve të këtyre fshatrave, të cilat janë shprehur edhe me protesta, prioritet për banorët e këtyre fshatrave është vazhdimi i funksionimit të këtyre shkollave.
65. Në fund të këtij raporti (faqe 22) nxirren përfundimet: "... Përballë këtyre ndryshimeve nuk kemi pasur një përgjigje institucionale përmes politikave konkrete..."; "...qeverisjet njëra pas tjetres e kanë vazhduar dinamikën e njëjtë të punësimeve sikur asgjë nuk ka ndodhur."<sup>23</sup> Nëse paraqitet numri i madh i punëtorëve, përveç risistemimit të brendshëm të të punësuarve, Komuna ka pasur obligim ligjor që ta kufizonte ose ta ndërpriste punësimin e punëtorëve të rinj.<sup>24</sup>

### Raporti i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike

66. Më 16 janar 2020, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, me qëllim të konstatimit të gjendjes higjieno-sanitare, e ka vizituar ShFMU "Fan S. Noli". Sipas raportit të tyre, nr.Prot.02/20, konstatohet se janë evidentuar shumë faktorë të cilët paraqesin rrezik për shëndetin e nxënësve, rekomandohet të ndërtohet një shkollë e re ose të bëhet riparimi komplet i objektit. Gjithashtu sipas tij, nëse këto rekomandime nuk realizohen për një afat të shkurtër, rekomandohet që mësimi të zhvillohet në një objekt tjetër në të mirë të ruajtjes së shëndetit të fëmijëve dhe të stafit. Përveç këtyre mangësive të evidentuara në këtë raport, përfaqësuesi i IAP-së ka vërejtur se kulmi i kësaj shkolle është i mbuluar me tjegulla me përmbajtje asbesti.<sup>25</sup>

### Memorandumi i Bashkëpunimit

67. Ligji për Arsimin Parauniversitar përcakton: "Ushtrimi i përgjegjësive dhe detyrave të komunës në këtë fushë **monitorohet nga Ministria** në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi." Përveç ligjeve nga fusha e arsimit, kompetencat e MASHTI-t përcaktohen sipas Shtojcës 6 të Rregullores Nr.02/2011, e cila po ashtu përcakton: "Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e arsimit.. (pika i.), përpilon, zbaton dhe mbikëqyrë format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe të menaxhimit të shkollave (pika iv.), përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit (pika v.)."
68. Duke u bazuar në këtë, MASHTI dhe Komuna duhet t'i ushtrojnë përgjegjësitë dhe detyrat e tyre të parapara me ligjet e zbatueshme në Kosovë, nëse paraqitet nevoja për riorganizim apo reforma në sistemin arsimor, atëherë kjo mund të bëhet vetëm sipas dispozitave ligjore.
69. Sipas paragrafit 1 të memorandumit përcaktohet: "Respektohet Vendimi me nr.të protokollit 26937 i datës 30.08.2019 i Komunës së Kamenicës për riorganizim të

<sup>23</sup> Avokati i Popullit vëren se edhe këtë vit, Komuna ka vazhduar të shpallë konkurse, më 18.2.2020 është shpallur Konkursi 02 Nr.4777, sipas të cilët kërkohen të punësohen dy (2) psikologë dhe pesë (5) punëtorë teknikë mirëmbajtës.

<sup>24</sup> Neni 76, par. 3, nënparr. 3.2.1 dhe 3.2.2, të Ligjit nr.03/L-212 të Punës.

<sup>25</sup> Shih Raportin me Rekomandime Ex Officio Rasti nr.12/2018, <https://www.oik-rks.org/2018/11/07/ex-officio-nr-122018-raport-lidhur-me-mosnderrmarrjen-e-obligimeve-positive-nga-organet-kompetente-per-menaxhimin-e-mbeturinave-me-permbajtje-asbesti/>, sipas të cilët materialet me përmbajtje asbesti paraqesin rrezik për jetën dhe për shëndetin e qytetarëve dhe kanë efekte negative në mëdis.

*shkollave që përfshinë shkollat “Fan S.Noli”, “Dëshmorët e Kombit”, “Hasan Prishtina”, “7 Shtatori”, “Idriz Seferi” dhe “Nuh Berisha.”*

70. Ndërsa sipas paragrafit 2 po ashtu përcaktohet: “*Shtyhet për fazën tjetër Vendimi me nr. të protokollit 805 i datës 10.01.2020, që përfshinë shkollat “Abdullah Krashnica Presheva” dhe “Rexhep Mala”. Koha kur do të fillojë së aplikuar ky vendim do të përcaktohet nga organi kompetent.*”
71. Duke i analizuar këta paragrafë, Avokati i Popullit vëren se kemi dy vendime të cilat e kanë bazën ligjore plotësisht të njëjtë, atëherë mbetet e pasqaruar çështja se pse, sipas marrëveshjes, njëri vendim respektohet ndërsa tjetri shtyhet për fazën tjetër.
72. Avokati i Popullit e përkrahë iniciativën për të nisur një studim të përgjithshëm lidhur me riorganizimin e shkollave me numër të vogël të nxënësve (par. 5), po ashtu Avokati i Popullit e përkrahë marrëveshjen e paraparë sipas paragrafit 7, që MAShTI dhe Komuna e Kamenicës, në konsultim me komunitetin, do të angazhohen në rivlerësimin e propozimit për riorganizim të arsimit të komunës së Kamenicës.
73. Ndërsa sipas paragrafit 8 parashihet: “*Të dy institucionet pajtohen që do të respektojnë vendimin e organit kompetent për organizimin e arsimit parauniversitar...*” Duke u bazuar në këtë, Avokati i Popullit konsideron se zbatimi i dispozitave ligjore është obligim i institacioneve e jo vullnet i lirë i tyre.

#### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

Në bazë të analizës së mësipërme, Avokati i Popullit konstaton:

74. Moszhvillimi i procesit mësimor në disa shkolla është i papranueshëm dhe në kundërshtim me të drejtat e fëmijës për arsimim, të parapara sipas nenit 47 të Kushtetutës.
75. Vendimet e kryetarit të komunës së Kamenicës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe me standardet e përcaktuara nga MAShTI, Komuna ka kompetenca në ofrimin e arsimit parauniversitar, mund edhe ta riorganizoje sistemin e arsimit në komunë, mirëpo duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm të lartcekur në këtë raport.
76. Duke u bazuar në Raportin Nr.Prot.02/20, i datës 16.1.2020, të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, si dhe në faktin se shkolla është e mbuluar me tjequlla me përbajtje asbesti, kryetari i komunës, para se të vendoste që nxënësit e fshatit Busavatë ta vijonin mësimin në ShFMU “Fan S. Noli” në Kamenicë, ka pasur për obligim ta dijë dhe ta ketë në konsideratë gjendjen e shkollës. Prandaj vendimi që nxënësit ta vijojnë mësimin në këtë shkollë nuk është në interesin më të mirë të fëmijëve dhe paraqet rrezik për shëndetin e tyre.
77. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, e institacioneve arsimore, e komunës dhe e qeverisë, sipas ligjeve përkatëse të zbatueshme në Kosovë, në rastin konkret, edhe pse janë mbajtur disa takime ndërmjet organeve komunale dhe komunitetit, nuk ka pasur mirëkuptim për të gjetur një zgjidhje të përbashkët.
78. Është obligim i përgjithshëm i MAShTI-t, i komunës, i institacioneve arsimore dhe i të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes ligjeve të arsimit, por edhe ligjeve të tjera në fuqi, që të ofrojnë

shërbime efikase dhe gjithëpërfshtirëse për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejta të barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e veçanta të tyre.

79. MASHTI, përmes Inspektoratit të Arsimit, ka pasur obligim ligjor ta përcjellë zbatimin e rekomandimeve, si rezultat i mosveprimit ato kanë mbetur të pazbatuara, prandaj, Inspektorati i Arsimit ka dështuar t'i ndërmerrte veprimet e parapara sipas Ligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.04/2019.<sup>26</sup>
80. Banorët e fshatrave Busavatë, Krilevë, Strezoc dhe Tugjec me të drejtë kanë pritur që MASHTI, si ministri e linjës, të përgjigjet në kërkuesat e tyre, mirëpo MASHTI, edhe përkundër obligimit ligjor, nuk është përgjigjur në kërkuesat e banorëve.<sup>27</sup>
81. Sipas dispozitave ligjore, MASHTI është kompetent për themelimin e shkollës dhe të paraleles së ndarë dhe se ministri i arsimit duhet të marrë vendim për themelimin e shkollës. Duke u bazuar në këtë, riorganizimi mund të bëhet vetëm pasi që ministri i MASHTI-t merr vendim.<sup>28</sup> Vendimet e nxjerra nga MASHTI<sup>29</sup> duhet të respektohen nga komuna, vendimet e tillë mund të anullohen apo të shfuqizohen vetëm nga organi i cili i ka nxjerrë, organi mbikëqyrës apo nga ndonjë organ tjetër i përcaktuar me ligj.<sup>30</sup>
82. Avokati i Popullit konstaton se organizimi i sistemit arsimor në Kosovë duhet të jetë i njëjtë në të gjitha komunat, prandaj riorganizimi i sistemit arsimor mund të bëhet vetëm nga MASHTI dhe në tërë territorin e Kosovës. Nëse riorganizimi bëhet nga kryetarët e komunave, atëherë mund të kemi dallime në sistemin arsimor dhe si pasojë edhe trajtim ndryshe.
83. Duke pasur parasysh se udhëzimi administrativ i cili rregullon raportin mësimdhënës-nxënës është nxjerrë në vitin 2013, kur në Kosovë ka pasur një numër më të madh të nxënësve, ndërsa prej asaj kohe kemi rënje të numrit të nxënësve, MASHTI duhet të nxjerrë një udhëzim administrativ të ri, i cili do të vendoste standarde ligjore të përshtatshme me situatën e krijuar për shkak të rënies së numrit të nxënësve.

Bazuar në analizën e mësipërme, Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18, paragrafi. 1.6, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, dhe nga vlerësimi i gjendjes faktike, i

## REKOMANDON

### Komunës së Kamenicës

<sup>26</sup> Më 19.7.2018, Avokati i Popullit, përmes Letër Rekomandimit Ex Officio A.nr.736/2017, i ka rekomanduar MASHT-it: "Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të krijoj parakushtet e nevojshme që Inspektorët e Arsimit të mund të zbatojnë sanksionet administrative. . ."

<sup>27</sup> Kërkesa Nr.prot:3319, datë 6.9.2019; dhe kërkesa Nr.prot:3480, datë 17.9.2019.

<sup>28</sup> Lidhur me këtë çështje, përfaqësuesi i IAP-së e ka marrë këtë përgjigje nga DKA-ja: "Vendim i ri për themelimin e shkollave nuk është nxjerrë, mirpo, në vetë Vendimin e Komunës obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që të ndjekë procedurat për themelimin e institucioneve arsimore, për të cilën ne jemi në proces."

<sup>29</sup> Neni 53, paragrafi 1, i Ligjit nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


<sup>30</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit e ka vetëm Vendimin 03.Nr.85-08, i datës 27.8.1996, për pavarësimin e paraleles së ndarë fizike, vendim i cili është siguruar nga drejtori i shkollës në fshatin Busavatë. Përfaqësuesi i IAP-së ka kërkuar nga DKA-ja në Kamenicë vendimet e MASHTI-t për themelimin e këtyre shkollave, më 11.11.2019, ka marrë përgjigje se DKA-ja nuk ka asnjë vendim për themelimin apo për riemërimin e këtyre shkollave dhe nuk kanë marrë asnjë vendim tjetër nga MASHTI.

1. Ta rivlerësojë Vendimin 02 Nr. 26937, i datës 30.8.2019, ashtu që riorganizimi të bëhet në mbështetje të plotë me dispozitat ligjore dhe në bashkëpunim me MASH-in.
2. Të angazhohet që, pa vonesa të mëtutjeshme, të shpërndahen tekstet shkollore për të gjithë nxënësit.
3. Të angazhohet që, pa vonesa të mëtutjeshme, të sigurohet që nxënësit e komunitetit rom ta vijojnë mësimin në gjuhën shqipe, gjuhë për të cilën janë përcaktuar sipas vullnetit të tyre.<sup>31</sup>
4. Pa vonesa të mëtutjeshme t'i zbatojnë rekomandimet sipas Raportit Nr.Prot.02/20, i datës 16.1.2020, të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Sidomos të largohet me urgjencë materiali me përbajtje asbesti.

#### Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

5. Të nxjerrë një udhëzim administrativ, përmes të cilit do të vendoste standarde ligjore në përputhje me situatën e krijuar me zvogëlimin e numrit të nxënësve në të gjitha komunat.
6. Të sigurojë që Inspektorati i Arsimit, si organ ekzekutiv qendror, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet edukativo-arsimore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paragjese atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.05/l-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

  
Me nederime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit

<sup>31</sup> Neni 59, paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

# SHTOJCË

## Instrumentet relevante ligjore

### Kushtetuta e Republikës së Kosovës

1. Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] përcakton: “*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.*”
2. Neni 24 përcakton: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*” (par.1).  
*“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhje me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”* (par.2).
3. Neni 53 i Kushtetutës përcakton: “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, ndërsa nen 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton se gjëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tillë si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
4. Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

1. *Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike.*
2. *Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.*
5. Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]
  1. *Fëmijët gjëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëgenien e tyre.*
  4. *Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.*
6. Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]

*Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:*

*(2) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njëren nga gjuhët zyrtare të Republikës se Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre;*

*(3) të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;*

7. Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. *Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gjëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.*

6. *Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.*

### **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut**

Neni 26. 3. *Prindër është kanë të drejtën parësore për zgjedhjen e llojit të arsimit për fëmijët e tyre.*

Neni 29. 2. *Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'u nënshtronhet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj, vetëm me qëllim të sigurimit të rjohjes dhe të respektimit të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive të të tjera të dëshira dhe të plotësimit të kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.*

### **Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës**

Neni 3. 1. *Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesit më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*

Neni 12. 1. *Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.*

2. *Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, (...).*

Neni 31. 1. *Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, (...).*

2. *Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.*

### **Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare**

Neni 12. 3. *Palët angazhohen të nxisin mundësi të barabarta për ndjekjen e arsimit në të gjitha nivelet për personat që i përkasin pakicave kombëtare.*

### **Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Neni 3 përcakton konceptin e diskriminimit: “*Parimi i trajtimit të barabartë nënkuption se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tertiortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, ndërsa “Diskriminim është çdo dallim, përashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gjëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovë.”*

### **Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**

Termi “*Vetëqeverisje lokale*”- do të thotë e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale, të themeluara sipas këtij Ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe *në interes të popullatës vendore*.

Ndërsa termi “*Kompetencat vetanake*”- do të thotë kompetencat që u jepen komunave me kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin.

Po ashtu termi “*Organi mbikëqyrës*”- do të thotë ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale dhe/ose institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 17, Kompetencat vetanake - “Komunat kanë kompetencia të plota dhe eksluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standarde e përcaktuare në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë: h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instrukturëve dhe administratorëve të arsimit.”

#### Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës

Neni 4, Kompetencat dhe Kompetencat e Zgjeruara të Komunave: “4.1 Komunat kanë kompetencia të plota dhe ekskluzive, për aq sa ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standarde e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve.”

Neni 5, Kompetencat e Komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollar, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë) përcakton: “*Punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër (pika c), zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit (pika d), regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë dhe licencimin e institucioneve arsimore parashkollore, (pika e), pagesën e stafit (pika f), trajnimin e edukatorëve dhe stafit tjetër profesional (pika g), mbikëqyrjen e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i (pika h).*

#### Ligji nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

Neni 1. 1. *Qëllimi i këtij ligji* është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.

Neni 3, Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

1. *Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.*
2. *Arsimi parauniversitar* është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj.

3. *Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë*

fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.

4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.

5. Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të:

5.1. **respektojnë** dhe **avancojnë** të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi.

Neni 7, Kompetencat e komunës

1. *Kompetencat e komunave janë të rregulluara përmes:*

1.1. Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L040, të datës 20 Shkurt 2008, dhe Ligjit për arsim në komuna, nr. 03/L-068, të datës 21 maj 2008, dhe

1.2. kompetencave shtesë të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji .

2. Ushtrimi i përgjegjësive dhe detyrave të komunës në këtë fushë **monitorohet nga Ministria** në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Rregullorja Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shtojca 6, përcakton se MASHT-i ka këto kompetenca: krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillim të arsimit (pika i), përpilon, zbaton dhe mbikëqyrë format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe të menaxhimit të shkollave (pika iv), përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet (pika v.) si dhe ndihmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore (pika vi).

### Ligji nr. 06/L -046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Neni 2. Ky ligj trajton mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime edukative, arsimore dhe aftësuese.

Neni 4. 1. Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit të MASHT-it.

Neni 13. 2. Inspektori i arsimit ndërpërt dhe ndalon:

2.2. punën e institucionit arsimor, personit juridik dhe fizik që ushtron veprimtari arsimore në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 14. 1. Për të gjitha inspektimet hartohet procesverbali në të cilin konstatohet gjendja faktike dhe propozohen masat e afatizuara për mënjanimin e lëshimeve.

2.2. nëse institucioni arsimor, publik, publiko-privat, privat, fetar, personi juridik dhe fizik, nuk i mënjanon lëshimet dhe parregullsitë në afatin e caktuar në bazë të rekomandimit, inspektori i arsimit do të marrë vendim për iniciimin e procedurës adekuate sipas shkallës së cënimit të ligjit;

2.4. Inspektori i arsimit është i obliguar ta përcjellë zbatimin e rekomandimit apo, vendimit.

**Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.04/2019 për ndërprerjen dhe ndalimin e punës së personit juridik dhe ndalimin e punës dhe inicimin e procedurës disiplinore të personit fizik**

*Neni 2, përcakton se: "Inspektori i arsimit me vendim do të ndalojë dhe ndërpresë punën e institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues nëse konstaton se:*

*1.1. Institucioni edukativo-arsimor dhe aftësues nuk ka licencë pune nga MASHT;*

*1.2. Veprimtarinë e vet e ushtron në kundërshtim me rregullativën ligjore në fuqi;*

*Neni 4, paragrafi 1, përcakton se: "Inspektori i arsimit ndalon punën dhe inicon procedurën disiplinore ndaj udhëheqësve të institucioneve edukativo-arsimore, aftësuese, nëse konstaton se:*

*1.1. Refuzon zbatimin e ligjeve, vendimeve të inspektoratit të arsimit, vendimeve të MASHT-it dhe akteve tjera nënligjore;"*

### **Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës**

*Neni 1. 1.2 "Republika e Kosovës ndërmerr masat e veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta. Këto masa nuk konsiderohen si akt diskriminimi."*

*Neni 8. Arsimimi, 8.1 "Të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njëren nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin. . . . Qeveria vendos pragjet e arsyeshme dhe të zbatueshme për themelimin e klasave apo shkollave të veçanta që funksionojnë në gjuhët e komuniteteve. Pragu minimal për klasa apo shkolla të tilla është më i ulët se pragjet e vendosura normalisht për institucionet dhe klasat shkollore. . . ."*

### **Ligji nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**

*Neni 53. 1. "Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjeter i përcaktuar shprehimisht me ligj.*

*3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë."*

**Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.08/2015 themelimi i institucioneve arsimore - ky UA ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe procedurave për themelimin e institucioneve arsimore, sipas nenit 2, përcaktohet: "**Themelimin e shkollës dhe të paraleles së ndarë fizike e bën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.**"**

Po ashtu sipas nenit 6 përcaktohet: "*Pas verifikimit të kushteve për zhvillimin e punës edukative-arsimore në shkollë, Ministri merr vendim për themelim.*"

**Udhëzimit Administrativ Nr.29/2012 themelimi i paralelevë të ndara,** nen 4 përcakton kriteret për themelimin e paraleles së ndarë, siç janë: "*Personeli i kualifikuar për mësimdhënës (par.1), Infrastruktura shkollore e nevojshme dhe e sigurt (par.2) dhe Largësia për udhëtim e nxënësve më shumë se dhjetë (10) kilometra në një drejtim për të ndjekur procesin mësimor*" (par.3).

Ndërsa nenit 5, paragrafi 1, përcakton: “*Pasi të ketë bërë analizën e cekur dhe të jenë plotësuar kriteret e parapara në nenin 3 të këtij udhëzimi administrativ, komuna mund të themelojë një paralele të ndarë. Ndërsa paragrafi 2, përcakton se: Një klasë e paraleles së ndarë duhet të ketë jo më pak se pesë (5) dhe jo më shumë se njëzet (20) nxënës.*”

**Udhëzimi Administrativ (MAShT) Nr.13/2016 pajisja e nxënësve me tekste shkollore,** përdorimi dhe ruajta e tyre, sipas të cilës përcaktohet mënyra e shpërndarjes së teksteve shkollore për nxënësit e arsimit të obliguar, sipas nenit 3, DKA-ja pranon tekstet shkollore nga shtëpitë botuese, ndërsa sipas nenit 4, DKA-të formojnë komisionet për pranimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore.

**Udhëzimi Administrativ Nr.22/2013 numri maksimal i nxënësve për klasë dhe rapporti mësimdhënës-nxënës,** sipas të cilës përcaktohet rapporti mësimdhënës-nxënës në arsimin parauniversitar, sipas nenit 3, paragrafi 3, përcakton: “*Raporti mësimdhënës-nxënës në nivelin e parë (1-5) është për nxënësit e komunitetit shumicë 1:21.3.*”, paragrafi 4, përcakton: “*Raporti mësimdhënës - nxënës në nivelin e dytë (6-9) është 1:21.3 për komunitetitn shumicë dhe 1:14.2 për komunitetin pakicë.*”

Paragrafi 6 i këtij nenit përcakton: “*Për nxënësit e shkollave të zonave malore (700 metra ose më tepër të lartësisë mbidetare) rapporti mësimdhënës-nxënës është 1:14.3 për komunitetin shumicë, si dhe 1:14.2 për komunitetin pakicë.*”

#### **Udhëzimi Administrativ Nr.24/2016 për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar**

Ky udhëzim administrativ përcakton mekanizmin dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, personelin përgjegjës dhe detyrat përkatëse, ngarkesën në punë dhe raportim lidhur me aktivitetet për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar. Sipas nenit 3, përcaktohen detyrat në nivel shkolle, në nivel komune dhe në nivel të MAShTI-t.

Sipas nenit 7, përcaktohet se koordinatori i cilësisë në nivel shkolle i raporton drejtorit të shkollës dhe anëtarëve të stafit, koordinatori për sigurim të cilësisë në nivel të DKA-së bashkëpunon dhe bashkërendon aktivitetet me koordinatorin e cilësisë i MAShTI-t, i cili shqyrton raportet e DKA-së dhe përgatit analiza përbledhëse duke përfshirë rekomandimet për përmirësim të cilësisë në nivel vendi.